

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR MARRJEN E MASAVE PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË RASTET E FATKEQËSIVE NATYRORE DHE KONFLIKTEVE TË ARMATOSURA”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i përgatitjes së projektvendimit është krijimi i një kuadri të posaçëm ligjor për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktit të armatosur.

Gjithashtu, ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e masave organizative, teknike, njerëzore dhe masave të tjera për ruajtjen e pasurive kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura.

Objektiv i këtij projektvendimi vendosja e rregullave për autoritetet shtetërore përgjegjëse, institucionet e vetëqeverisjes vendore, si dhe pronarët ose poseduesit e pasurive kulturore për detyrimin dhe përgjegjësinë që kanë nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit, për marrjen e masave, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit të riskut dhe minimizimin e dëmeve ndaj pasurive kulturore, që vijnë si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERË POLITIKË

Projektvendimi “Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura” është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare dhe angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Kulturës në kuadrin e hartimit dhe përmirësimit të akteve me fuqi ligjore dhe nënligjore.

Ministria e Kulturës është angazhuar në përgatitjen e këtij projektvendimi, në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka në kompetencë, si organ

përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore.

Ky akt është parashikuar në Planin Analitik të Projektakteve për vitin 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Nisur nga situata e fatkeqësisë natyrore në vend ,(tërmeti i vitit 2019) me pasoja në pasuritë kulturore por dhe nga situata të tjera, është vlerësuar e nevojshme të parashikohen dhe të qartësohen detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse duke shtuar masa të reja apo duke riformuluar disa prej tyre, si dhe duke përcaktuar procedurat për marrjen e masave për zgjidhjen e problematikave në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktit të armatosur. Këto përcaktime do të bëjnë të mundur ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktit të armatosur.

Në legjislacionin shqiptar ekziston një kuadër ligjor për sa i përket mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe në rastet e konfliktit të armatosur, por me ligjin e ri nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i cili ka përthithur legjislacionin evropian ka parashikuar nën nenin 11 të tij, që shteti të sigurojë posaçërisht marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura, duke njohur kështu rëndësinë dhe vlerën që kanë objektet e trashëgimisë kulturore për kulturën dhe zhvillimin e shoqërisë.

Kjo do të bëhet në bashkëpunim të autoriteteve shtetërore qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilët do të bashkërendojnë punën, koordinojnë, harmonizojnë dhe integrojnë aktivitetet, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura.

Secili organ përgjegjës që ngarkohet për zbatimin e këtij projektvendimi, sipas kompetencave ligjore do të hartojë planet e masave, koordinoj punën, organizmin e trajnimeve etj., për parandalimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Ky projektvendim del në bazë dhe për zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë së projektvendimit, nga pikëpamja formale ai përbën një akt nënligjor të nxjerrë në respektim të kriterëve të parashikuara nga neni 118 i Kushtetutës.

V.PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT.

Synimi i VKM-së është marrja e masave për zvogëlimin e riskut, si dhe organizimin e angazhimit në përballimin e emergjencave civile në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktesh të armatosura.

Projektvendimi është ndarë në 6 krerë:

Kreu I parashikon dispozitat e përgjithshme.

Kreu II parashikon strukturat përgjegjëse për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në rastet e fatkeqësive natyrore. Strukturat përgjegjëse për ruajtjen e trashëgimisë kulturore kanë detyrimin për bashkëpunimin ndërinstitucional në rastet e fatkeqësive natyrore. Ministrinë përgjegjëse kanë përgjegjësinë për marrjen e masave për organizimin dhe përballimin e emergjencave civile në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktit të armatosur. Në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor i Emergjencave Civile i cili këshillon për zvogëlimin e riskut ku përbërja dhe funksionet e tij miratohen me urdhër Ministri. Institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore bashkërendojnë punën me Komisionin Teknik Këshillimor të Emergjencave Civile në marrjen e masave për parandalimin, menaxhimin e situatës si dhe zvogëlimin e riskut për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në këto raste komunikimi mes institucioneve bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar.

Kreu III parashikon masat për ruajtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore në rast të fatkeqësive natyrore. Projektvendimi përcakton masat paraprake për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore. Këto masa janë të ndara në dy faza: a) masat paraprake ku përfshihen hartimet e planeve dhe data bazat,

organizimi i sistemit të paralajmërimit, trajnimet e strukturave përgjegjëse dhe b) masat për përballimin dhe rehabilitimin e pasurive kulturore që është një fazë e cila konsiston në angazhimin e strukturave përgjegjëse në zbatimet e planeve, nxitjen e bashkëpunimit dhe stimulimin e vullnetarizmit.

Kreu IV parashikon masat për ruajtjen e pasurive kulturore në rast të konflikteve të armatosura . Në këtë kre janë përcaktuar masat paraprake në kohë paqeje dhe masat gjatë konfliktit të armatosur. Këto masa kanë si synim ruajtjen e pasurisë kulturore bazuar në pasojat e parashikuara gjatë një konflikti të armatosur ku në këto masa përfshihen inventarizim, plane dhe trajnimi i strukturave përgjegjëse.

Në pikën A parashikohet vendosja në mbrojtje të veçantë, duke përcaktuar se cilat janë pasuritë kulturore të cilat vendosen në mbrojtje të veçantë, përcakton kriteret për vendosjen në mbrojtje të veçantë të pasurive kulturore si dhe kriteret për vendosje në mbrojtje të veçantë për venddepozitimet për ruajtjen e pasurive kulturore të luajtshme gjatë sulmeve ushtarake. Ministrat përgjegjës në konsultime paraprake miratojnë listën e pasurive kulturore që vendosen në mbrojtje të veçantë e cila i propozohet drejtorit të përgjithshëm të OKB-së.

Në pikën B parashikohet shenja dalluese. Projektvendimi në këtë aspekt përcakton se çfarë konsiderohet shenjë dalluese, vendi ku do vendoset shenja dalluese , mënyra si do vendoset ajo.

Në pikën C parashikohet zhvendosja dhe qarkullimi i pasurive kulturore. Përcakton mënyrën e zhvendosjes së pasurive kulturore të luajtshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj në një situatë të konfliktit të armatosur që realizohet nën mbrojtje të veçantë. Për zhvendosjen nën mbrojtje të veçantë të pasurive kulturore realizohet kërkesa e cila përmban një sërë kriteresh për realizimin e saj.

Në pikën Ç parashikohen veprimtaritë arkeologjike në rast të konflikteve të armatosur. Si rregull gjatë konfliktit të armatosur ndalohet çdo veprimtari arkeologjike. Por në raste përjashtimore lejohen disa veprimtari që kanë për qëllim shpëtim apo ruajtjen e gjetjeve arkeologjike e gjitha kjo nën monitorimin e ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen.

Në pikën D parashikohen masat ushtarake. Në udhëzimet aktuale ushtarake janë të përcaktuara dhe të integruara dispozita që sigurojnë respektimin dhe zbatimin e Konventës “Mbi mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të armatosur”. Ky personel i dedikuar për mbrojtjen e pasurive kulturore është pjesë e përbërëse e Forcave të armatosura të cilat gjatë operacioneve zbatojnë masat përkatëse.

Në kreun V përcaktohet Edukimi dhe trajnimi. Ministrinë përgjegjëse bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për trajnimin e specializuar në nivel profesional dhe teknik të strukturave përkatëse të mbrojtjes civile me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Kreu VI parashikon dispozitat e fundit, duke parashikuar se ngarkohet ministria përgjegjëse për kulturën, ministria përgjegjëse për mbrojtjen, institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e specializuara përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT.

Për zbatimin e këtij akti, ministria përgjegjëse për kulturën, ministria përgjegjëse për mbrojtjen, institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e specializuara përgjegjëse.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Ky projektvendimi është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim, me kontribut nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen dhe ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

Ministria e Mbrojtjes, në cilësinë e bashkëpropozuesit me shkresën me nr. 1546/2 prot, datë 09.04.2021 dhe në rrugë elektronike me e-mailin e datës 07.07.2021 ka paraqitur sugjerimet përkatëse, konkretisht:

Lidhur me sugjerimin në pikën 1, pse është hequr togfjalëshi...dhe fatkeqësitë e tjera, ju bëjmë me dije se bazuar në pikën 3, neni 11 i ligjit 27/2018 (dispozitë autorizuese) parashikohet se: “Shteti siguron marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura. Këto masa ruajtëse propozohen nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ministri përgjegjës për mbrojtjen, ministri përgjegjës për punët e brendshme dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Lidhur me sugjerimin në pikën 2, kudo në tekstin e projektvendimit togfjalëshi ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile është zëvendësuar me termin ministria e mbrojtjes.

Lidhur me sugjerimin në pikën 3, ku kërkohet që të shtohet Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, pavarësisht se ky institucion nuk është krijuar ende, sugjerimi është marrë parasysh dhe reflektuar në pikën 2 të Kreut II.

Lidhur me sugjerimin në pikën 4 mbi heqjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile, sqarohet se është krijuar njësi njësi përgjegjëse e Emergjencave Civile për pasuritë kulturore. Njësia e Emergjencave Civile për pasuritë kulturore bashkërendon punën me Agjencinë Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore

Lidhur me sugjerimin në pikën 5, drafti është rikonceptuar dhe ripunuar me saktësimet dhe referencat e sakta.

Lidhur me sugjerimin në pikën 6 lidhur me hartimin e procedurave dhe vendosja e sinjalistikave si pikë më vetë, ky sugjerim është marrë parasysh dhe reflektuar në tekstin e projektvendimit.

Ministria e Brendshme me shkresën me nr. 3775/1 prot, datë 19.08.2021 është shprehur parimisht dakord dhe ka bërë disa sugjerime, të cilat janë reflektuar në tekstin e projektvendimit.

Sipas sugjerimit në pikën 1 është marrë parasysh dhe është hequr përcaktimi i ministrisë së Brendshme si fushë e përgjegjësisë.

Sipas sugjerimit në pikën 2, kudo në projektvendim është zëvendësuar togfjalëshi “Ministri përgjegjës për çështjet e brendshme” me “Ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike”.

Sipas sugjerimit në pikën 3, është riformuluar shkronja “c” e pikës 9, e Kreut II si vijon: “Nxitja e pronarëve dhe/ose administratorëve të pasurive kulturore për kompletimin, me pajisje paralajmëruese, me masa parandaluese dhe mjete portative automatike për mbrojtjen nga zjarri të objektit.”

Sugjerimi në pikën 4 dhe 5, është marrë parasysh me argumentin se : Ministria e Brendshme është e nevojshme të jetë në cilësinë e bashkpropozuesit, vetëm për arsye të bazës ligjore autorizuese të pikës 3 të nenit 11 të ligjit 27/2018 pasi në aspektet përmbajtësorë të aktit në lidhje me fushën e kompetencës, për shkak të

ndryshimit te legjislacionit ne kohë, ministria përgjegjëse për emergjencat civile është Ministria e Mbrojtës. Projektvendimi, gjithashtu është nisur për mendim ne Këshillin Konsultativ te Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

VIII.RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit .

IX.HYRJA NË FUQI E PROJEKTVENDIMIT.

Ky projektvendim hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

